



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËSË  
DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË  
DHE EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nr. 3227 prot.

Tiranë, më 03.06.2022

Lënda: Mbi kërkesën e shoqërisë "ATEANI ENERGY" sh.p.k.

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

**Për dijeni:**

**SHOQËRISË "ATEANI ENERGY" sh.p.k**

Rr. "Kuvendi Dukagjinit", Lagjja "Partizani", Ndërtesa Ish Markata, Nr. 2, Burrel

Ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë "Ateani" sh.p.k., është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" me Nr. 2234 Rep., Nr. 1082/1 Kol., më datë 15.08.2017, për ndërtimin e hidrocentraleve "Shutri 1" dhe "Shutri 2" në pellgun ujëmbledhës të lumit të Shutrisë, e ndryshuar me kontratën shtesë Nr. 2576 Rep., Nr. 1226/3 Kol., datë 19.12.2018. Shoqëria "ATEANI ENERGY" sh.p.k është shoqëria koncesionare e krijuar në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni.

Shoqëria "ATEANI ENERGY" sh.p.k. me shkresën e saj datë 14.04.2022, protokolluar në MIE me Nr. 3227, datë 15.04.2022, ka kërkuar miratimin e Autoritetit Kontraktues, për transferimin e 82% të kuotave të kapitalit themeltar të saj të zotëruara nga shoqëria "Ateani" sh.p.k në favor të shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k, duke depozituar bashkëlidhur kërkesës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë shitblerje kuotash të kapitalit themeltar, ndërmjet shoqërisë "Ateani" sh.p.k. dhe shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k., Nr.1932 Rep. Nr.730 Kol, datë 13.04.2022;
2. Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për shoqërinë "Ateani Energy" sh.p.k;
3. Ekstrakt historik i shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k.;
4. Objekti i veprimtarisë së subjektit "BESNIKU" sh.p.k. është në fushën energjitike;
5. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës në emër të shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k.;
6. Vërtetim nga Prokuroria Kukës në emër të shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k.;
7. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore në emër të administratorit të Shoqërisë z. Dervish Domi;
8. Vërtetim për shlyerje detyrimesh tatimore në emër të shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k. lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore;
9. Vërtetim për shlyerje detyrimesh tatimore në emër të shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k. lëshuar nga Drejtoria e Taksave Vendore;

10. Vërtetim për pagesën e sigurimeve shoqërore në emër të shoqërisë “BESNIKU“ sh.p.k.;
11. Listë Pagesat e Sigurimeve për vitin 2021 dhe Janar-Mars 2022 në emër të shoqërisë “BESNIKU“ sh.p.k.;
12. Vërtetim i Zyrës së Përmbartimit Kukës në emër të shoqërisë “BESNIKU“ sh.p.k.;
13. Struktura organizative e shoqërisë BESNIKU“ sh.p.k.;
14. Përshkrim i kapaciteteve teknike, organizative dhe profesionale të shoqërisë“BESNIKU“ sh.p.k.;
15. Vetë-Deklarim për informacion, dokumente, kontrata të ngjashme;
16. Çertifikate e Regjistrimit në QKR/NIPT me vulë elektronike.
17. Kartë identiteti të Administratorit z. Dervish Domi.
18. Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore mbi Pasqyrat Financiare, viti 2019, 2020, 2021;
19. Vërtetim nga FSHU që subjekti “BESNIKU” sh.p.k, nuk ka detyrime;
20. Dokument bankar që vërteton se “BESNIKU” sh.p.k, disponon 20% të vlerë së investimit të përgjithshëm të propozuar;
21. Kontratë bashkëpunimi për mjetet, pajisjet teknike në dispozicion qpo që mund të vihen në dispozicion nga “BESNIKU” sh.p.k, për ATEANI Energy sh.p.k.;

Përsa i përket kriterëve ligjore, financiare dhe teknike të shoqërisë blerëse “BESNIKU” sh.p.k. rezulton se ajo i përmbush kriteret dhe ky transferim është i vlefshëm me kushtin që të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 17, në Kontratën e Koncesionit midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

Për sa më sipër, MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktues shprehet parimisht dakord për miratimin e këtij transferimi dhe referuar pikës 3, neni 32 të Ligjit 125/2013 “Për Koncesionet /PPP” po ju përcjellim për miratim kërkesën e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k., protokolluar me Nr.3227 Prot., datë 15.04.2022.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

